

Bashkë jemi
më të sigurtë

Raport **Vjetor**
2016



RAPORT VJETOR 2016

www.insig.com.al

Shqipëri

Rruga “Kavajës”,Nr. 116,
Tiranë ALBANIA
Tel : +355 04 2234170
Fax : +355 04 2223838
E-mail:info@insig.com.al

Kosovë

“Rruga Pashko Vasa”,
nr,4, Prishtinë
Tel.: +381 38 549 904
Fax: +381 38 549 904

RAPORT VJETOR

2016



i madh dhe i sigurt

Përmbajtja

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm.....	5
Tregu i sigurimeve.....	6
Paraqitja e INSIG.....	7
Pronësia mbi kompaninë	8
Organigrama e Insig sh.a.	10
Aktiviteti sigures	11
Pasqyra e pozicionit financiar	14
Dëmet nga Veprimtaria siguruese	15
Shenim mbi pasqyrat financiare	17
Raport (Përmbledhje).....	20

Të nderuar lexues, miq dhe klientë të INSIG!

Është një privilegj i veçantë, që në zbatim të detyrës që më është caktuar për të drejtuar shoqërinë e sigurimeve INSIG sh.a, të paraqes përpara Jush, Raportin Vjetor për vitin 2016, i cili pasqyron një përmbledhje të sfidave, zhvillimeve, rreziqeve dhe arritjeve të shoqërisë sonë përgjatë këtij viti. Gjithashtu dhe vizionin, strategjinë për vitin 2017, ambiciet dhe pikat e mbështjetjes së kësaj strategjie.

Viti 2016 ishte një vit i tranzicionit dhe ndryshimeve. Unë jam i bindur se strategjia dhe struktura jonë e re do të na mundesojë përmbushjen e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive që shfaqen në vijim.

Privatizimi i INSIG sha nga kompania EUROSIG Sh.A ka sjellë bashkëimin e eksperiencave dhe njohurive të dy kompanive të mëdha duke krijuar një standard të shkëlqyer në treg.

Treguesit ekonomike dhe financiarë dëshmojnë së INSIG sha ka përmbushur konsiderueshëm objektivat e vendosura nga programi financiar dhe i veprimtarisë së shoqërisë, duke mbajtur nivelin e duhur të kapitalit si dhe duke investuar mjetet e saj në tregun financiar në funksion të garantimit të aftësise paguese dhe prezencës në treg.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur, pasqyrohen disa të dhëna dhe tregues financiarë për vitin ushtrimor 2016.

Fusha e Sigurimit Motorrik, sikurse për të gjitha shoqëritë e tjera që operojnë në treg, edhe për INSIG vijon të mbetet veprimtaria kryesore e cila kontribuon dhe ndikon në arritjen e objektivave të tij, si për shtimin dhe zgjerimin e klientelës, ashtu edhe për rritjen e të ardhurave të shoqërisë. Kjo fushë e veprimtarisë sonë të sigurimeve, përbën rreth 75% të të ardhurave nga primet ose 804,046 mijë lekë për sigurimin e jo jetës (Për Shqipërinë).

Në fushën e Sigurimit të Pasurisë, të ardhurat bruto nga primet (Për Shqipërinë) janë në shumën 144,918 mijë Lekë. Ky tregues, është rezultat i një angazhimi të veçantë të INSIG për të përmirësuar veprimtarinë e marrjes në sigurim në këtë fushë të sigurimeve të jo-jetës, si një nga elementët e rëndësishëm për rritjen e portofolit dhe të fitimit të shoqërisë edhe në të ardhmen.

Në fushën e sigurimit Jetë & Shëndet, tregu i sigurimeve ka reflektuar problemet dhe vështirësitë e tregut financiar në tërësi. Megjithatë, duke u bazuar në njohuritë e specialistëve tanë mbi trendet e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe jetëgjatësisë etj, INSIG sha ka bërë përpjekje të vazhdueshme për t'u ofruar klientëve zgjidhje të përshtatshme për të siguruar rrezikun e tyre dhe nevojat e menaxhimit të kapitaleve. Në këtë fushë të sigurimeve të ardhurat

Raport vjetor 2016

bruto të INSIG sha Shqipëri për vitin 2016 janë në shumën 122,895 mijë Lekë.

Të gjithë këta tregues pozitiv janë realizuar falë përkushtimit dhe profesionalizmit të stafit të shoqërisë ne INSIG, kujdesit dhe mbështetjes së akcionarëve dhe Këshillit Mbikëqyrës.

Ne jemi të angazhuar jo vetëm për të kuptuar klientët tanë, nevojat dhe pritshmëritë e tyre, por përpiqemi ti tejkalojmë ato me shërbim të personalizuar.

Insig ka përballuar testin e kohës duke qëndruar i madh dhe i sigurt prej dekadash dhe objektivi jonë për 2017 është të vazhdojmë të rritemi e të përforcohemi duke garantuar shërbimin cilësor dhe siguri për klientët të cilët i kanë besuar shoqërisë sonë mbrojtjen e interesave dhe asetëve të tyre me vlerë.

Sinqerisht,

Erald HËSA

Drejtore i Përgjithshëm i INSIG Sh.a

Zhvillimet e tregut 2016

Në vitin 2016 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 9.64%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 1,358,522 mijë lekë duke arritur shifrën 15,446,218 mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në 1,126,233 duke shënuar një rritje me 2.66% krahasuar me vitin 2015.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 14,384,340 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 10.25% krahasuar me vitin 2015.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,012,595 duke shënuar një rritje në masën 2.97% krahasuar me vitin 2015.

Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 977,932 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 4.82% krahasuar me vitin 2015.

Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 113,611 duke shënuar një ulje në masën 0.06% krahasuar me vitin 2015.

Gjatë vitit 2016, janë paguar gjithsej 4,276,089 mijë lekë dëme ose 17.54% më shumë se gjatë vitit 2015.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2016 është rritur me 2,157 dhe arriti shifrën 31,415 nga të cilat 30,272 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 1,143 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.



III. RRETH KOMPANISE

INSIG sh.a është kompania e parë e sigurimeve dhe e vetme në historikun e zhvillimit të tregut shqiptar të sigurimeve, i cili ka luajtur një rol të padiskutueshëm në krijimin, zhvillimin dhe konsolidimin e këtij biznesi në ekonominë e vendit.

INSIG SHA ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimeve, prej më shumë se 25 vite në shitjen e produkteve të jo jetes dhe jetes. Rezultatet e INSIG-ut duken në të ardhurat e saj në rritje nga viti në vit, në gamën e produkteve që ajo i ofron klienteve nepermjet rrjetit të shitjes dhe degeve në rrethe, në zgjerimin e aktivitetit të saj sigurues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në investimet finaciare. Të gjitha këto arritje janë realizuar me bashkëpunim të vazhdueshëm dhe mbështetjen teknike me partneret tane kudo në botë. Pas shumë viteve veprimtarie në treg me uljet dhe ngritjet e saj, kjo kompani u privatizua në 13 maj 2016.

Kompania Eurosig finalizoi blerjen e gjithë paketës së aksioneve të shoqërisë Insig sha (e vetmja kompani shtetërore në vend), duke paguar njëkohësisht 2.2 miliarde leke në buxhetin e shtetit. Si rezultat i blerjes së aksioneve të shoqërisë Insig-Jetë dhe Jo Jetë Shqipëri, Kosovë & Maqedoni, kapitali i shoqërisë Eurosig u rrit nga 592,050,000 Lek në 2,275,650,000 Lek.

Një ndër objektivat më të rëndësishme ishte dhe vazhdon të jetë rritja e saj në tregun e sigurimeve duke patur një shtrirje gjeografike, kryesisht në zonat me më shumë përqëndrim të sigurimeve, rritje të kontakteve direkte me klientët dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre, reklama dhe marketing intensiv, si dhe përmirësimi i produkteve ekzistuese të sigurimeve dhe rritja e shitjeve, veçanërisht të produkteve të reja“.

Ndërsa shpejtësia dhe korrektësia në trajtimin e dëmëve, përmirësimi i infrastrukturës e penetrimi i tregut vullnetar, si grup, duke bashkësiguruar me Eurosig, e bënë INSIG edhe më të besueshme për klientët.



Paraqitja e Insig gjate 2016

Gjatë vitit 2016, INSIG sh.a. vijoi kryerjen e veprimtarisë së saj të shtrirë në tre territore, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Duhet theksuar se përgjatë 2016 Insig Maqedoni pesoi ndryshim në emertimin e saj në Eurosig Maqedoni.

Sigurimet e jo-jetës në të tre vendet u përfaqësuan nga produkte të ndryshme, që mbulojnë përgjegjësinë e mbajtësve të mjeteve motorike kundrejt palëve të treta, kasko, zjarrin dhe rreziqet shtesë, vjedhjen, sigurimet e bankave, tipe të ndryshme të përgjegjësisë, marinën dhe mallrat në transport, bujqësinë dhe blegtorinë, etj.

Sigurimet e jetës të ofruara nga Kompania konsistojnë kryesisht në produkte afatshkurtra, si sigurimi i jetës individuale dhe në grup, sigurimi i jetës së nxënësit dhe studentit, sigurimi i jetës së debitorit, sigurimi i kombinuar i jetës, sigurimi i Jetës dhe Shëndetit. Duhet theksuar se fund 2016 kompania Insig ndoqi një sërë procedurash deri në finalizimin e ndarjes së kompanisë në dy të vecanta si Insig jete dhe Insig jo-jete.

Gjatë vitit 2016, INSIG sh.a. ruajti marrëdhënie të qëndrueshme të biznesit me lojtarë të rëndësishëm të tregjeve ndërkombëtare të sigurimeve dhe risigurimeve. INSIG cedoi një pjesë të rreziqeve tek risiguruesit ndërkombëtarë, duke u bazuar në ligjet përkatëse në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni dhe në deklaratën e politikës së veprimtarisë.

Në 25 vite veprimtari, INSIG-u ka përmirësuar ndjeshëm kapacitetet e burimeve njerëzore, nëpërmjet politikave të pranimi dhe programeve të vazhdueshme të trajnimit.



IV. PRONËSIA MBI KOMPANINË

Ne përputhje me Statutin e kompanisë, Neni 6, kapitali themeltar është 1,020,000,000 lekë (nje miliard e njezete milione), i ndarë në 1,700 (njëmijë e shtatëqind) aksione, me vlerë nominale 600,000 (gjashtëqindmijë) lekë secili. Gjatë vitit 2016, aksionet e shoqërisë iu shiten në masën 100% shoqërisë se sigurimeve Eurosig sh.a.

Këshilli Mbikqyrës :

Vasil Pilo – Kryetar
Rexhep Mejdani – Anëtar
Thanas Xhillari- Anetar

Organizimi i Kompanisë :

Rrjeti i Shpërndarjes së INSIG sh.a.


Degët dhe numri i punonjësve

2016 Nr. Mesatar i punonjesve te INSIG sh.a. QENDER - 80



Shqipëri

Gjendja 31.12.2016		
Nr. rendor	Deget / Agjencite	Nr. i punonjesve
1	BERAT	2
2	DIBER	2
3	DURRES	4
4	ELBASAN	4
5	FIER	4
6	GJIROKASTER	3
7	KAVAJE	2
8	KORCE	3
9	KUKES	2
10	LAÇ	1
11	LEZHE	1
12	LUSHNJE	3
13	POGRADEC	3
14	SARANDE	3
15	SHKODER	3
16	TIRANE	10
17	VLORE	3
	Total Dege / Agjenci	53




Kosovë

Gjendja 31.12.2016	
Filijali	Nr. i punonjesve
Qender	21
Prishtine - Mitrovice	2
Ferizaj - gjilan	2
Prizren	1
Peje - Gjakove	2
Totali	28

INSIG
i madh dhe i sigurt

Organigrama




VI. TREGUESIT FINANCIARË

AKTIVITETI SIGURUES

Në vitin 2016 u shkruan 1,463,119 mije lekë prime nga sigurimet e jo-jetës dhe sigurimet e jetës. Shpërndarja territoriale e primeve për vitin 2016 ishte: Shqipëri 73%, Kosovë 27%. Rreth 75% e primeve të shkruara bruto erdhi nga sigurimet motorrike, 14% nga sigurimet e pronës, 10% nga sigurimi i jetës, dhe 1% nga sigurimet e jetës dhe të shëndetit.

Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas territoreve


Prime të shkruara bruto	viti 2016	viti 2015
Shqipëri	73%	72%
Kosovë	27%	28%
Total	100%	100%



Raport vjetor 2016


Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për Grupin INSIG:

Lloji i produktit	viti 2016	viti 2015
Mjete motorrike	75%	69%
Pasuri	14%	19%
Jete	10%	10%
Shendet	1%	2%
Total	100%	100%



Shpërndarja e primeve të shkruara bruto sipas linjave të biznesit për Kosovën

Lloji i produktit	viti 2016	viti 2015
Mjete motorrike	97%	98%
Pasuri	3%	2%
Jete	-	-
Shendet	-	-
Total	100%	100%



Raport vjetor 2016

DËME TË PAGUARA

Përgjatë vitit 2016 INSIG sh.a. u fokusua në përmirësimin e ndjeshëm të shërbimit ndaj klientit nëpërmjet procedurave më fleksibile dhe të shpejtë. Gjatë vitit 2016 vlera e dëmeve të paguara kapin shifrën prej 758,846,396 leke

Deme te paguara ne leke (Grupi)	
2016	758,846,396 leke
2015	728,841,208 leke

PASQYRE E HUMBJEVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA PERMBLEDHESE E KONSOLIDUAR


(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

	Shenime	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Prime te shkruara bruto	29	1,469,310,394	1,170,867,417
Ndryshimi neto ne rezerven e primeve te pafituara	20	-290,693,782	-103,782,444
Prime të shkruara neto		1,178,616,612	1,067,084,973
Prime te ceduara risiguruesve	30	-111,535,791	-98,728,612
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara për pjesën e risiguruesit		2,311,365	-3,358,703
Prime të fituara neto	31	1,069,392,186	964,997,657
Të ardhura të tjera nga marrja në sigurim	19	11,885,642	10,477,426
Shpenzimet e dëmeve dhe te trajtimit te dëmeve	32	-1,387,589,323	-695,796,964
Shpenzimet e marrjes ne sigurim	33	-189,090,675	-161,722,832
Shpenzime administrative		-687,931,060	-401,648,879
Humbje operative		(1,183,333,230)	(283,693,592)
Të ardhurat financiare	35	47,142,714	63,248,271
Të ardhura/(humbje) nga kurset e këmbimit, neto	36	-10,037,803	23,665,303
Të ardhura financiare neto		37,104,911	86,913,573
 (Humbja)/fitimi para tatimit		 (1,146,228,319)	 (196,780,018)
 Tatimi mbi fitimin	37	 (33,219,323)	 -16,106,603
Humbja e vitit		(1,179,447,641)	(212,886,621)
Të ardhura përmbledhëse të tjera			
Rezerva përktimi			
Tatimi i shtyrë nga rezerva e katastrofës			
Totali i (humbjes)/të ardhurave përmbledhëse të vitit		(1,179,447,641)	(212,886,621)


Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	7	21,261,959	65,687,043
Depozita me afat me bankat	8	53,824,227	652,415,716
Investime të mbajtura në maturim	9	1,241,849,465	1,521,755,613
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	10	61,043,957	38,321,956
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	11	156,747,648	54,881,653
Aktive të risigurimit	12	329,727,867	353,996,462
Të arkëtueshme nga risiguruesit	13	135,731,877	2,759,127
Parapagim i tatimit mbi fitimin		21,140,420	41,515,515
Aktive të tjera	14	1,000,998,910	32,821,139
Aktive afatgjata materiale	15	138,474,216	127,869,508
Aktive afatgjata jo-materiale	16	5,421,968	4,248,284
Të drejta ndaj Eurosig AD		-	27,181,252
Marëdhënie me degën Insig Sh.a Kosovë	17	-	155,656,513
Pjesmarrje në shoqëri të kontrolluara	18	380,245,000	380,245,000
TOTALI I AKTIVEVE		3,546,467,514	3,459,354,781
DETYRIMET			
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	19	1,183,921,672	1,174,902,737
Rezerva për primet e pafituara	20	658,370,987	412,466,195
Të pagueshme ndaj risiguruesve	21	19,727,190	15,767,604
Detyrimet e qirasë financiare	22	5,246,974	-
Llogari të tjera të pagueshme nga sigurimi	23	116,794,982	59,278,617
Provigjione	24	6,996,678	11,810,860
Tatim i shtyrë		7,236,625	7,236,625
Të pagueshme ndaj shoqërive të kontrolluara		9,588,195	-
Marëdhënie me degën Insig Sh.a Kosovë	17	940,139,709	-
TOTALI I DETYRIMEVE		2,948,023,012	1,681,462,638
KAPITALI			
Kapitali aksionar	25	1,020,000,000	1,020,000,000
Rezerva rivlerësimi	26	180,626,537	180,626,537
Rezervë për parandalimin e dëmeve	27	44,677,559	44,677,559
Rezerva të tjera	28	1,050,611,336	1,050,611,336
Rezerva nga kursi këmbimit		8,828,000	8,828,000
Fitimi i vitit		92,052,643	(20,848,653)
Humbje të mbartura		(1,798,351,573)	(506,002,635)
TOTALI I KAPITALIT		598,444,502	1,777,892,144
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		3,546,467,514	3,459,354,781

Këto pasqyra u miratuan nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 16 prill 2017 dhe u firmosën në emër të tij nga:


Z. Erald Hysa
Drejtor i Përgjithshëm




Znj. Antoneta Marcellari
Drejtoresh e Departamentit të Finances

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 46, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare për qëllime të veçanta.

Raport vjetor 2016

PASQYRE E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TE PARASE

(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK,pervecse kur percaktohet ndryshe)

Fluksi i parase nga aktivitetet operative	31 Dhjetor 2016	31 Dhjetor 2015
Humbja pas tatimit		
Rregullime për:	-1,146,228,319	-196,780,018
Zhvlerësimin	12,742,547	14,235,278
Nxjerrja jashtë përdorimit	50,700,201	26,674,714
Shpenzimet e zhvlerësimit	3,512,899	996,066
Të ardhura nga interesi	-47,142,714	-63,248,271
Ndryshime nga kursi i këmbimit	23,943,753	-5,695,589
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative	-1,102,471,633	-223,817,820
Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative		
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe llogari të tjera të arkëtueshme	-68,733,928	43,955,092
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	-133,262,757	-22,609,658
Ndryshimi në aktive të risiguruar	23,736,040	-98,798,557
Ndryshimi në detyrime të risiguruar	-132,972,750	5,224,707
Ndryshimi në aktive të tjera	-963,034,353	-2,157,605
Ndryshimi në detyrime të tjera	413,078,047	42,151,041
Ndryshimi në provigjione të tjera	975,353,341	232,691,282
Tatimi mbi fitimin i paguar	-12,394,655	-23,040,035
Flukset monetare të gjeneruara/(te perdorura) nga aktivitetet operative	-1,000,702,648	-46,401,553
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje paisjesh dhe aktivesh jo materiale	-32,523,025	-190,799
Ndryshim në depozitat me afat	636,645,462	81,436,850
Blerje e bonove të thesarit	296,130,000	-226,440,000
Interesa të marra	31,603,053	44,747,589
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet investuese	931,855,490	-100,446,360
Flukset monetare nga aktivitetet financuese		
Dividend i paguar	0	0
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese		
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	-68,847,158	-146,847,913
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim të vitit	144,865,619	291,713,532
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund të vitit (Shënimi 8)	76,018,461	144,865,619

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Më poshtë pëfshihet një informacion përmblledhës nga pasqyrat financiare të audituara

Deklaratë e përputhjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS), të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe investimeve të mbajtura për tregtim të cilat janë paraqitur me vlerën e drejte.

Monedha funksionale dhe e prezantimit

Keto pasqyra financiare të konsoliduara janë të prezantuara në Leke, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale e Grupit.

Baza e Konsolidimit

Filialet

Filialet janë ato entitete të cilat janë të kontrolluara nga Grupi. Kontrolli ekziston kur Grupi ka fuqinë, në mënyrë direkte dhe indirekte, të qeverisë politikën financiare dhe operative të një entiteti si dhe të sigurojë përfitime nga aktiviteti i tyre. Pasqyrat financiare të filialeve janë të përfshira në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të ushtrimit të kontrollit deri në datën kur ky kontroll mbaron.

Menaxhimi i Rrezikut Financiar

Grupi monitoron dhe menaxhon rrezikun financiar që lidhet me operacionet e saj përmes analizave të brendshme të riskut të cilat përshkruajnë shkallën dhe rëndësinë e riskut. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (risku i monedhës, risku i normave të interesit), riskun e kredisë dhe riskun e likuiditetit. Grupi nuk përdor instrumenta financiarë derivativë për t'u mbrojtur nga ekspozimi ndaj këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku i një impakti financiar negativ si rrjedhojë e ndryshimeve të tregut të tilla si ndryshimet në kurset e këmbimit, në normat e interesit dhe ndryshime të tjera në çmime. Risqet e tregut krijohen për shkak të luhatjeve si në vlerën e aktiveve ashtu edhe të detyrimeve të mbajtura. Shoqëria ka përcaktuar politikën dhe procedurën për menaxhimin e riskut të tregut.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione si në monedhën lokale ashtu edhe në monedha të huaja; ndaj edhe lind rreziku prej luhatjes së kurseve të këmbimit. Për këtë arsye, luhatjet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja mund të ndikojnë nivelin e kapitalit të aksionerëve si rezultat i kësaj përkthimit të tij në monedhën lokale. Risku i monedhës në portofolin e investimeve menaxhohet përmes përdorimit të parimit të përputhshmërisë së aktiveve me detyrimet.

Risku i kredisë

Risku i kredisë i referohet riskut që pala tjetër do të dështojë në obligimet e saj kontraktuale duke rezultuar në humbje financiare për Shoqërinë. Përgjatë kursit normal të biznesit, teksa arkëtohen primet, këto fonde investohen për të shlyer obligimet e ardhshme të policave. Shoqëria ekspozohet ndaj riskut të kredisë

Raport vjetor 2016

përmes titujve të borxhit të mbajtur deri në maturim, depozitave me afat, të arkëtueshmeve të sigurimit dhe kundërpartitë e risigurimit. Grupi ka vendosur procedura të brendshme dhe udhëzime sipas të cilave partnerët e risigurimit duhet të kenë vlerësime BBB ose më të larta dhe të plotësojnë kërkesat e Grupit për të përket Rregullave të Sigurisë për Risigurimet. Grupi menaxhon ekspozimin ndaj riskut të kredisë në mënyrë të rregullt përmes monitorimit të ekspozimit ndaj titujve të borxhit dhe kundërpartitë e depozitave me afat

Analiza e sensitivitetit

Tabela e mëposhtme detajon sensitivitetin e Shoqërisë ndaj rritjes dhe uljes së Lekut përkundërt monedhave të tjera relevante. Ky ndryshim në kurset e këmbimit përdoret kur bëhen raportimet e brendshme të riskut nga kurset e këmbimit për personelin e lartë menaxherial dhe përfaqëson vlerësimin e menaxhimit mbi ndryshimet e mundshme të kurseve të këmbimit valutor. Në cdo analizë sensitiviteti paraqitet ndikimi i ndryshimit të një faktori të vetëm, ndërsa faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, në analizën e sensitivitetit. Analiza e sensitivitetit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

		2016	2015
EUR rritet me 10 % kundërt Lekut	Fitim	2,069,650	11,359,743
EUR bie me 10 % kundërt Lekut	Humbje	(2,069,650)	(11,359,743)
USD rritet me 10 % kundërt Lekut	Fitim	23,769,084	6,190,020
USD bie me 10 % kundërt Lekut	Humbje	(23,769,084)	(6,190,020)
GBP rritet me 10 % kundërt Lekut	Fitim	327,411	388,812
USD bie me 10 % kundërt Lekut	Humbje	(327,411)	(388,812)

Rreziku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve të ardhshme monetare të një instrumenti financiar do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe nga risku që maturitetet e aktiveve që mbartin interes do të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes dhe që janë përdorur për të financuar këto aktive. Kohëzgjatja brenda së cilës norma e interesit e një instrumenti financiar qëndron e fiksuar përcakton edhe shkallën e riskut të normës së interesit ndaj të cilit ekspozohet instrumenti. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 Shoqëria nuk ka pasur detyrime të rëndësishme interesmbajtëse dhe as instrumenta me norma të ndryshueshme, por përqendrimin më të madh të rrezikut të normës së interesit e ka lidhur me depozitat me afat dhe bonot e thesarit, të cilat kanë maturitet 3 muaj deri në 1 vit.

Risku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë obligimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen. Risku i likuiditetit është një risk i moderuar i brendshëm për aktivitetin e biznesit të Shoqërisë sepse disa prej aktiveve të blera dhe detyrimeve të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqëria do të kërkonte shuma të konsiderueshme brenda një periudhe të shkurtër duke tejkaluar kërkesat normale për mjete monetare, ajo mund të përballej me vështirësi për të siguruar çmime tërheqëse. Pavarësisht kësaj, Shoqëria ka akses në huamarrje më 31 dhjetor 2016 dhe 2015. Shoqëria administron riskun e likuiditetit përmes monitorimit të vazhdueshëm të fluksit të parasë të parashikuar dhe atij aktual, duke përputhur maturitetet e aktiveve dhe detyrimeve financiare.

Supozime dhe sensitiviteti

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kuantitative të sensitivitetit. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë treguesë të tillë si raporti i humbjes së pritur.

Grupi e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihen në pasqyrat e pozicionit financiar. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Rezultatet e analizës së sensitivitetit që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara (në '000 Lek):

Raporti i demeve	Impakti	2016	2015
5 % rritje ne raportin e demeve	Humbje	(4,198,300)	(19,990,749)
5 % renie ne raportin e demeve	Fitim	4,198,300	19,990,749

Raporti i shpenzimeve			
5% rritje ne raportin e shpenzimeve	Humbje	(28,098,232)	(18,273,174)
5% renie ne raportin e shpenzimeve	Fitim	28,098,232	18,273,174

Raporti i kombinuar			
5 % rritje ne raportin e kombinuar	Humbje	(32,296,533)	(38,263,923)
5 % renie ne raportin e kombinuar	Fitim	32,296,533	38,263,923



RAPORT (Përmbledhje)

Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2016.

1.Baza ligjore që rregullon veprimtarinë e AB në shoqërinë INSIG sha.

- Ligji 52/2014 “ Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit “ , Rregullore e AMF nr. 153/2015 “ Për veprimtarinë e njësisë së AB dhe Komitetit të Auditimit në Shoqëritë të Sigurimit”.
- Rregullore “ Për veprimtarinë e AB në INSIG sha” miratuar me vendim të KM nr. 21 date 20.07.2015 Rregullore “ Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit” miratuar me vendim të KM nr. 39 date 12.11.2015.

2.Organizimi dhe funksionimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm.

- Veprimtaria e AB është përshtatur me kërkesat e Ligjit 52/2014 dhe Rregulloret e AMF, duke siguruar një funksionim dhe pavarësi të plotë të njësisë . Ketë mënyrë funksionimi, pavarësie dhe raportimi , Njësia e AB e ka ruajtur edhe pas privatizimit të INSIG sha në vitin 2016
- Njësia e AB, aktualisht ka në përbërje 2 auditues (Drejtor dhe 1 specialist auditimi). Audituesit kanë kualifikimin e nevojshëm dhe përvojën në fushën e auditimit në sigurime sipas kërkesave të rregullores së AMF (mbi 5 vite në njësinë e auditimit në shoqërinë INSIG sha).
- Njësia e AB varet dhe raporton në Këshillin Mbikëqyrës dhe Komitetin e Auditimit . Aktiviteti i Auditimit është monitoruar dhe mbikëqyrur me korrektësi dhe në vazhdimësi nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti i Auditimit, si (Shqyrtimi i raporteve të auditimit, miratimi i rekomandimeve, miratimi i planit të auditimeve, etj.).

3.Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2016.

- Njësia e AB në zbatim të planit vjetor të auditimit, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 42 datë 12 nëntor 2015, për vitin 2016 ka realizuar këto misione auditimi :

Subjekte të audituara	Plani	Realizuar	Dif.	Evaduar	Rekomandime të dhëna
Misione auditimi (Departamente, dege, Zyra, etj.)	19	19		19	151

Njësia e AB INSIG sha, për vitin 2016 sipas planit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, ka mbuluar me auditim, 6 Departamente dhe 10 Dege/ Zyra.

Janë realizuar gjithsej 19 misione auditimi nga 19 misione të planifikuara. Nga këto : Auditime të plota 13 ,Auditime të përputhshmërisë 2 , Auditime financiare 1 dhe Auditime për zbatimin e rekomandimeve 2 misione auditimi.

4.Gjetjet dhe Konstatimet të klasifikuara sipas sistemeve dhe fushave të audituara :

- Strukturat e shoqërisë INSIG sha në përgjithësi kanë ushtruar veprimtarinë në përputhje me kornizën ligjore si të Ligjit të Sigurimeve dhe Risigurimeve dhe rregulloreve të AMF(Marrja në Sigurim, Trajtimi dëmeve, menaxhimi i rrisqeve,etj)
- Të gjitha strukturat kanë angazhimin dhe përgjegjësinë për zbatimin e politikave të aksionarit, të rregulloreve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës si dhe udhëzimeve dhe urdhrave të menaxhmentit të kompanisë.

4.1Konstatime lidhur me sistemin e marrjes ne sigurim dhe administrimin e policave.

- Per funksionimin e strukturave te Shitjes dhe marrjes ne sigurim, është rekomanduar për një balancim me te qarte ndërmjet funksioneve autorizuese, kontrolluese dhe zbatuese me qellim parandalimin nga risqet operationale dhe risqeve te marrjes ne sigurim. Ky rekomandim është zbatuar ne vitin 2017.
- Për marrjen ne Sigurim te produkteve, INSIG ka një baze rregullative dhe procedura te mjaftueshme. Gjithsesi për te reflektuar problematikat e hasura gjate marrjes ne sigurim si dhe ne kushtet e privatizimit te kompanisë, per disa produkte është rekomanduar dhe po bëhen përmirësime ne kushtet e përgjithshme dhe udhëzimet e marrjes ne sigurim.
- Strukturat përkatëse , kane bere analizat periodike për rezultatin teknik te produkteve. Por, menaxhimi duhet ti konsideroje rezultatet e këtyre analizave, me qellim marrjen e masave ne korrigjimin e tarifave, uljen e nivelit te shpenzimeve operative dhe veqanerisht kostot e marrjes ne sigurim, kjo ne funksion te përmirësimit rezultatit teknik financiar te produkteve.
- Të gjitha produktet shiten dhe administrohen në programin e shitjes on- linë (E –Insure dhe MSHM), kjo ka realizuar saktësi ne lëshimin e policave. Për te minimizuar rrisqet operacinale dhe te mashtimit te marrjes ne sigurim është rekomanduar qe për produktet Kasko dhe Pasuri te qendërzohet ne programin e shitjes edhe sistemi tarifar , fotot e objektit , pyetësorët dhe kufizimi sipas nivelit autorizues te shumes se siguruar, etj. Ky rekomandim eshte zbatuar ne vitin 2017.
- Ne përgjithësi praktikat e marrjes ne sigurim janë te plotësuar me dokumentacionin e kërkuar.
- Ne marrjen ne sigurim te Përgjegjësisë BBB dhe CIS & CIT, duhet bere një analize paraprake e riskut ne baze te historikut te ngjarjeve te ndodhura, te behet verifikim i sigurimit te Kontratës se Shoqërisë se Ruajtës Fizike te Bankës, duke e përfshire edhe ne kushtet e marrjes ne sigurim, etj. Kërkesat e veçanta te cilat i konsiderojmë te rëndësishme, duhet te përcaktohen ne një shtojce te veçante ose te merren konfirmime deklarative nga banka.
- Nga verifikimi dhe inventarizimi i policave ne rrjetin e shitjes , nuk kane rezultuar diferenca ne polica sigurimi si dhe ne përgjithësi zbatohen rregulloret e administrimit te policave.
- Degët, agentet dhe rrjeti i shitjeve ne përgjithësi kane zbatuar udhëzimet dhe procedurat e marrjes ne sigurim si ne plotësimin e dokumentacionit, zbatimin e niveleve te kompetencave ne sistemin tarifar dhe shumes se siguruar. Kane dorëzuar rregullisht policat dhe te dhënat ne qendër duke rakorduar çdo muaj.
- Për mangësitë e konstatuar ne Sistemin e marrjes ne sigurim te produkteve Jo Jete , me qellim përmirësimin e punës dhe zbatimin korrekt te procedurave te marrjes ne sigurim, strukturave përkatëse u janë dhëne për zbatim 12 rekomandime .

4.2Konstatime nga vlerësimi i sistemit te menaxhimit te rrezikut.

- Në zbatim të ligjit 52/2014, dhe të rregullores së AMF “ Për rregullat e Organizimit të Sistemit të Administrimit të Rrezikut në Shoqërinë e Sigurimit “(Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 18, datë 28.04.2015) : Është miratuar rregullorja “Mbi Administrimin e Rrezikut INSIG sha „(Miratuar me Vendimin nr. 23 , datë 20 Korrik 2015 të Këshillit Mbikëqyrës të INSIG sha.). Është ngritur Komiteti i Auditimit dhe Administrimit të Rrezikut ,ku mbulon edhe përgjegjësitë e Administrimit te Rrezikut.
- Eshte kërkuar qe te hartohen plane dhe strategji afatgjata, te cilat japin një orientim me te qarte ne te gjitha strukturat mbi mënyrat dhe rrugët ne arritjen e objektivave dhe monitorimin e rreziqeve. Ky rekomandim është zbatuar pjesërisht pasi kompania ka hartuar një plan biznesi 3 vjeçar.
- Është e domosdoshme qe veprimtaria aktuariale te përqendrohet jo vetëm për llogaritje te treguesve aktuariale (provigjone, tarifime etj.) por dhe analiza te detajuar dhe te thelluara me qellim paralajmërimin ne kohe te treguesve ne përkeqësim. Kjo kërkon investim ne kapacitete njerëzore

dhe dhe sisteme/programme ne funksion te analizave dhe raporteve te mirëfillta aktuariale. Është rekomanduar qe te pasurohet sistemi online me programe elektronike qe sigurojnë analiza dhe raporte te mirëfillta dhe ne eficence te veprimtarisë aktuariale.

- Është menaxhuar sipas rregullave ne fuqi mbajtja e SI nga INSIG, pra ne te gjitha rastet SI mbi nivelin e 10 % te kapitalit (aftësisë paguese) është mbuluar me risigurim. Marrëveshja e risigurimit te pronës 2016-2017, është lidhur me kushte me te disfavorshme se viti 2015/2016, kjo është rrjedhoje e ndodhjes se dy dëmeve CIT (cash ne transit) gjate vitit 2015, ku solli dhe ndryshimin e kushteve te marrëveshjes.
- Provigjonet teknike me 31.12.2015 dhe periodikisht gjate vitit 2016 janë miratuar nga AMF si te rregullta dhe ne pajtueshmëri me ligjin.
- INSIG sha me Vendim Bordi Nr. 34 date 24.03. 2016 është njohur me Primet e Rrezikut ne nivel tregu (Vendim Bordi AMF Nr. 34 date 24.03. 2016) te cilat duhet te merren për baze, por konstatohet një difference midis tarifave te llogaritura nga shoqëria dhe tarifave te ardhura nga Autoriteti. Kjo difference e llogaritjes se primit , sipas Aktuarit te kompanisë mund te prodhoje efekte negative për sa i takon Kartonit Jeshil, duke qene se ky produkt ka një nivel te larte primi rreziku te llogaritur nga shoqëria.
- Është hartuar raporti i vetëvlerësimit te risqeve dhe është dërguar Brenda afatit ligjor ne AMF. Raporti i vetëvlerësimit te risqeve te INSIG për vitin 2016 , pas rekomandimit nga AB është analizuar ne Komitetin e Auditimit dhe Këshillin Mbikëqyrës te INSIG duke dhëne edhe rekomandimet përkatëse.

4.3 Konstatime nga Vlerësimi i sistemit se Teknologjisë Informacionit,

- Veprimtaria e teknologjisë se Informacionit dhe Siguria e Informacionit ne INSIG sha, është normuar me Rregulloren “ Për Politiken e Sigurisë se Informacionit ne INSIG sha” miratuar me vendim te Këshillit Mbikëqyrës nr. 36 date 12 nëntor 2015.
- Kërkohet rregullimi i funksionimit dhe vartësisë se IT. Është rekomanduar te funksionojë si njësi me vete.
- Analiza e rrisqeve te TI duhet te realizohet dhe dokumentohet ne vazhdimësi për çdo komponent dhe element kyç te sigurisë se informacionit, ti behën prezent drejtimin te kompanisë dhe te kërkohet marrja e masave për minimizimin apo eliminimin e rrisqeve konkrete.
- Kompania INSIG sha, ka garantuar ushtrimin e aktivitetit te saj duke implementuar strukturën e rrjetit te vete lokal dhe atë te shitjeve.
- Pavarësisht masave parandaluese qe janë marre nga IT, ne serverat e Kompanisë duhet instaluar program i licencuar antivirus. Kjo vlerësohet një rrisht për sigurinë e informacionit.
- Duhet rregulluar Backup-i i te dhënave me server pasi aktualisht kryhet manualisht ne HDD te jashtëm USB (ne dy kopje).
- Për menaxhimin e Vazhdimësisë se Aktivitetit , është ne proces vendosja e një strukture dytësore te ngritur ne një godine te dyte.
- Kontrolli i Aksesit (e drejta dhe rishikimi i aksesit). Te gjithë punonjësit e INSIG sha kane te drejtën e një hapësire personale ne server.
- Përputhja me Ligjin (Prona Intelektuale) Te gjithë kompjuterat kane te licencuar programin Windows. Serverat , kane licence për sistemin operativ. SQL server për sistemin e shitjes, financës, dëmeve është me licence.
- Struktura e IT, ka monitoruar funksionimin e programit te shitjeve on-line, programit Financiar dhe programit te dëmeve. Por kërkohet qe te përfundoje integrimi i plote këtyre programeve tek njeri tjetri.
- Për te përmirësuar punën ne sektorin e IT, Auditimi i Brendshëm ka dhëne 13 rekomandime, te cilat janë miratuar ne Këshillin Mbikëqyrës. Strukturat përkatëse po punojnë për zbatimin e rekomandimeve.

4.4 Konstatime nga Vlerësimi i sistemit të financës dhe Kontabilitetit .

- Për veprimtarinë e financës, kontabilitetit, raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm, ka baze rregullative të mjaftueshme . Pas privatizimit të kompanisë ,është rekomanduar të behën qartësime dhe ndryshime rregullative për funksionimin e kontabilitetit , politiken e investimeve , etj.
- Janë nxjerre brenda afateve ligjore bilancet financiare dhe raportet që kërkohen nga autoritet drejtuese të kompanisë dhe autoriteti mbikëqyrës AMF. Është rekomanduar që , Te miratohen dhe zbatohen afate konkrete për regjistrimin e veprimeve në kontabilitet (jo me vone se data 10 e muajit pasardhës) si dhe afate për rakordimin me degët dhe departamentet , etj.
- Departamenti i Financës duhet të pozicionohet me qarte si departamenti i ngarkuar për menaxhimin financiar të kompanisë dhe Drejtori i Financës si nëpunësi kryesor zbatues. Kjo ndihmon menaxhimin efektiv, shmang abuzimet si dhe adreson përgjegjësitë personale për çdo specialist sipas niveleve të autorizimit që vepron.
- Ky departament ka bërë analiza financiare periodike. Por si departamenti i ngarkuar për menaxhimin financiar të kompanisë, duhet të bëjë analiza dhe japë informacione here pas here për problematika të veçanta me rrisqe të larta.
- Në përgjithësi ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm brenda Departamentit të Financës, si në drejtim të miratimit dhe zbatimit të procedurave të pagesave, menaxhimit të shpenzimeve, administrimit të investimeve financiare, kryhen kontrole paraprake të dokumentacionit të pagesave, janë bërë verifikime të limiteve për shpenzimet e limituara si shpenzimet telefonike, energji elektrike, etj.
- Për të rritur cilësinë e kontrollit të brendshëm , me qëllim shmangien nga penalitet e ndryshme dhe mbrojtjen e kompanisë nga risqet operationale dhe ligjore , Për veprime dhe operatione financiare të rëndësishme të kompanisë, është rekomanduar që të realizohen konsulta me departamentet operationale (ku duhet të siglojnë dokumentacionin përkatës të veprimeve) me qëllim plotësimin e dokumentacionit dhe vendimmarrjen sipas kërkesave të statutit të INSIG sha dhe legjislacionit që rregullon veprimtarinë e shoqërisë.
- Nga verifikimet e kryera konstatojmë se në llogarite rrjedhëse në leke për të cilat kanë ardhur konfirmimet nga bankat nuk paraqiten diferenca midis gjendjes kontabël, statementeve të bankave dhe konfirmimit të sjelle prej tyre.
- Nga verifikimi me zgjedhje të praktikave të pagesave kryer nëpërmjet bankave është konstatuar se në përgjithësi janë zbatuar me korrektësi Rregulloret përkatëse.
- Në zbatim të rregullores të menaxhimit të shpenzimeve miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, nga strukturat e INSIG duhet të behën analiza periodike të realizimit të zërave të shpenzimeve administrative dhe për çdo problematike apo tejkalim të buxhetit të vihet në dijeni Këshilli Mbikëqyrës.
- Administrimi dhe Inventarizimi i policave në magazine është kryer konform rregulloreve . Është rekomanduar që programi i shitjeve të integrohet me programin e kontabilitetit edhe për seritë e policave që janë në magazine dhe në rrjetin e shitjes.
- INSIG ka rakorduar periodikisht dhe në fund të vitit me organet tatimore. Me shkresën Nr.16957 date 23/08/2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj, konfirmohet se INSIG sha i regjistruar me NIPT-J62006012D, nuk ka detyrime tatimore të pa shlyera.

4.5 Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm (Departamente dhe struktura të tjera)

- INSIG rregulla dhe procedura korrekte të miratuara lidhur me sigurimin e cilësisë së operationeve të veprimtarisë së INSIG. Ka procedura dhe rregullore të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës , lidhur me identifikimin, matjen dhe monitorimin e nivelit të rreziqeve si dhe parandalimin dhe administrimin efektiv të tyre.
- Në rregulloret e miratuara por dhe në zbatimin praktik në përgjithësi ka ndarje funksionesh për

Raport vjetor 2016

verifikimin , kontrollin, autorizimin e operacioneve në marrjen në sigurim, te trajtimit te dëmeve , te kryerjes se pagesave, etj.

- Sistemi i pagesave qe nga kontrolli i faturave, verifikimi nga departamentet operacionele, verifikimi nga departamenti i financës dhe urdhër pagesa me dy firma te autorizuar , kane rritur nivelin e kontrollit te pagesave.
- Por është konstatuar se ne disa raste kërkohet një harmonizim dhe koordinim me efikas midis degëve me departamentet përkatëse por dhe midis departamenteve me qellim qe çdo veprimtari dhe veprim te jete i kontrolluar dhe i monitoruar ne kohe (paraprakisht) dhe jo pas kryerjes se veprimit.
- Auditimi i brendshëm për çdo subjekt te audituar (departamente dege, etj.) ka vlerësuar se si ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm.

5.REKOMANDIMET E DHËNA DHE ZBATIMI .

Mbështetur ne gjetjet e auditimit për përmirësimin e mangësive janë dhëne edhe rekomandimet përkatëse. Analiza për rekomandimet e dhëna dhe zbatimi për vitin 2016 (Totali) :

Subjekte te Audituar (Departamente, Dege, Zyra, etj)	Rek. Te dhëna	Rendesia e rekom.			Rek. Te zbatuara	Rendesia e rekom.			Rekom. ne proces	Rendesia e rekom.		
		e larte	e mesme	e ulet		e larte	e mesme	e ulet		e larte	e mesme	e ulet
19	151	48	96	7	115	31	78	6	36	17	18	1

- Rekomandimet e dhëna nga Auditimi i Brendshëm për çdo subjekt janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës se INSIG sha me vendime rast pas rasti. Shkalla e pranimi dhe miratimit te rekomandimeve nga Këshilli Mbikëqyrës është ne nivelin 100 %, pra rekomandimet janë miratuar pa masa plotësuese. (Komiteti i Auditimit gjate shqyrtimit ka bere plotësime për 4 rekomandime te dhëna nga Auditimi Brendshëm).
- Klasifikimi i rekomandimeve : Me rëndësi te larte 48 rekomandime ose 32 % , me rëndësi te mesme 96 rekomandime ose 63 % dhe me rëndësi te ulet 7 rekomandime ose 5 %.
- -Ne përgjithësi rekomandimet janë ndjekur dhe zbatuar sipas kërkesave te rregulloreve përkatëse. Niveli i rekomandimeve ne proces ose te pa zbatuara prej 22 % është i pranueshëm, kjo pasi disa auditime janë realizuar ne muajit e fundit te vitit 2016 prandaj kane një shtrirje te realizimit edhe gjate 6 mujorit 2017.
- Departamenti i AB do monitoroj ne vazhdimësi zbatimin e rekomandimeve te dhëna gjate vitit 2016 dhe do raportoje ne Këshillin Mbikëqyrës brenda muajit qershor 2017.

6. Plani i Auditimit Brendshëm ne INSIG sha për vitin 2017

- Plani i auditimit për vitin 2017 dhe strategjik 2017-2019 është miratuar me vendim te Këshillit Mbikëqyrës nr. 14 date 23 dhjetor 2016.
- Objekte dhe fusha për tu audituar në vitin 2017:
- Gjithsej do kryhen 29 auditime (Departamente, Dege, Zyra Përfaqësimi, etj.).
- Niveli i vlerësimit të riskut për 29 objektet qe auditohen është : - objekte dhe fusha me risk të larte 7 - me risk të mesëm 22 objekte.

Raporti “Mbi Veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë INSIG sha për Vitin 2016” është miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe Këshilli Mbikëqyrës ne mbledhjen e datës 24 maj 2017 dhe sipas kërkesave ligjore është depozituar brenda afatit ligjor edhe ne Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare (AMF).